



**Republika e Kosovës / Republic of Kosovo**  
**Komuna - Municipality**  
**Hani i Elezit**



0101/ Nr. 2523 /2018  
Data: 20.03.2018

**PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS**

Procesverbal nga mbledhja e dytë- II- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 27.02.2018 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Sevime Laçi (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Medina Imishti (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Nexhmedin Daci (drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Nustret Shiti (Koordinatorë i Këshillave të Fshatrave), Ajete Berisha (Udhëheqëse e Personelit), Irfan Suma (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit), dhe qytetarë të ndryshëm të komunës së Hanit të Elezit. Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i kuvendit të komunës.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Miratimi i raportit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2017.
3. Shqyrtimi i raportit të punës së kryetarit të komunës për vitin 2017.
4. Miratimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2017.
5. Miratimi i planit të punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2018.
6. Rishqyrtimi i vendimit të komitetit për politik dhe financa.
7. Miratimi i propozimit për dhënien e pëlqimit për kompaninë "ACHRO" SH.P.K.
8. Shqyrtimi i informatës mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2017-2018.
9. Pyetje dhe përgjigje.

**Kryesuesi** thekson:- përveç këtyre pikave të rendit të punës keni edhe një material shtesë për ndërrim destinim të pronës. Arsyja e procedimit të këtij materiali është për shkak se parashtruesin e kërkesës mos me vonuar. Lidhur me rendin e punës hapi diskutimin.

**Sabrije Krasniqi** thekson:- kërkojë që në rend dite të përfshihet edhe një pikë rreth problemeve të cilat janë tu ndodhë te lagjja e Thaçve në fshatin Paldenicë.

**Kryesuesi** thekson:- unë mendoj që te pika e ndryshme me diskutuar për këtë çështje.

**Mefail Suma** thekson:- për pikën e dytë të rendit të ditës mendojë që më mirë të jetë informim i raportit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2017. Te pika e tretë e rendit të punës shqyrtimi i raportit të punës së kryetarit të komunës për vitin 2017. Në bazë të nenit 15 të rregullores së punës së kuvendit të komunës parashihet që kuvendi i komunës e miraton. Pika e gjashtë e rendit të punës rishqyrtimi i vendimit të komitetit për politik dhe financa, kam menduar që ka mbajtur mbledhje komiteti për politikë dhe financa që e ka shqyrtuar materialin dhe najë ka dërguar. Nëse mendoni me anuluar vendimin e më parshëm më mirë do të ishte të potencohej miratimi i ndryshimit të pjesshëm të vendimit të komitetit për politik e financa.

**Kryesuesi** thekson:- kjo pikë e rendit të punës është e paraparë me plan të kuvendit të komunës. Me ligj të vetëqeverisjes lokale parashihet që të miratohet raporti i punës së kuvendit të komunës. Pika e gjashtë e rendit të punës është shënuar në këtë mënyrë për shkak se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar që të bëhet rishqyrtimi i vendimit.

**Rufki Suma** thekson:- deri para dy apo tri viteve i kemi miratuar raportet e punës së kryetarit të komunës, mirëpo kjo çështje është praktikuar kur kryetari i komunës është zgjedhur prej kuvendit të komunës dhe ka qenë oblikative që të miratohet raporti i punës. Tash është një procedurë tjetër për shkak se kryetari i komunës zgjidhet drejtë për drejtë nga qytetarët dhe e njofton kuvendin e komunës për aktivitete e ekzekutivit përvitin 2017. Kemi parashtruar pyetje në Ministri të Pushtetit Lokal dhe përgjigje kanë dhënë që raporti i punës së kryetarit nuk miratohet në kuvend.

**Mefail Suma** thekson:- termi rishqyrtim, termi shqyrtim dhe termi miratim kanë ndryshime në mes veti. Ne e kemi miratuar atë vendim dhe nëse e ka dërguar Ministria e Pushtetit Lokal për rishqyrtim mendoj që e ka gabim për shkak se ne nuk e kemi shqyrtuar por e kemi miratuar dhe nëse prapë ne e rishqyrtojmë duhet ta anulojmë. Nëse është më lehtë për administratën duhet të potencohet miratimi i ndryshimit të pjesshëm të vendimit për shkak se vetëm një emër ka me ndryshuar.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- këtë çështje kemi diskutuar edhe në nivel të grupit të shefave parlamentare për shkak të kthimit të vendimit nga MAPL-ja. Vendimi i MAPL-së është që të rishqyrtohet aj vendim të cilin e kemi miratuar në kuvend dhe nuk besoj që ka diçka nëse bëhet rishqyrtim apo ndryshim i pjesshëm, mirëpo na duhet ta rishqyrtojmë vendimin të cilin e kemi marr për arsy se MAPL kështu e ka kthyer dhe nuk është shumë e komplikuar me potencuar përmënyrën se si e emërojmë. Ne po e marrim një vendim ashtu siç jemi dakorduar në nivel të shefave të grupeve parlamentare.

**Kryesuesi** thekson:- unë mendoj që kuptohet që është i pjesshëm sepse këtu është në pyetje barazia gjinore. A ka edhe ndonjë diskutim, nëse nuk ka e hedh në votim materialin shtesë, rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri, (prezent ishin 15 këshillat të komunës).

## U MIRATUA RENDI I PUNËS

### Procedojmë me këtë rend të punës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Miratimi i raportit të punës së kuvendit të komunës përvitin 2017.
3. Shqyrtimi i raportit të punës së kryetarit të komunës përvitin 2017.
4. Miratimi i raportit të shpenzimeve buxhetore përvitin 2017.
5. Miratimi i planit të punës së këshillit komunal përsiguri në bashkësi përvitin 2018.
6. Rishqyrtimi i vendimit të komitetit përpolutik dhe financa.
7. Miratimi i propozimit përdhënien e pëlqimit përkompaninë "ACHRO" SH.P.K.
8. Shqyrtimi i informatës mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2017-2018.
9. Miratimi i kërkesës së z.Muhamed Suma për ndërrim destinim të pronës.
10. Pyetje dhe përgjigje.

### 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin,

**Florim Shkreta** thekson:- faqe njëmbëdhjetë të plotësohen fjalët, sepse humbjen e kam pranuar me komoditet por kam pas edhe kënaqësi kur ju z.Sumës ju keni bërë presion partive të tjera që mos të kenë kandidat përkryetar komune. Kjo më ka pëlqyer sepse diçka nuk ka qenë në rregull me ty. Faqe 13 të plotësohet fjalë e z.Sumës që potencon se në qoftë se edhe një herë ndërhyjë në projekte të njoftohet policia dhe të arrestohet Florim Shkreta si administrator i fshatit Seçishtë.

**Kryesuesi** thekson:- ka edhe ndonjë vërejtje, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

## MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## **2. Miratimi i raportit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2017.**

**Kryesuesi** thekson:- kuvendi i komunës gjatë vitit 2017 ka planifikuar t'i mbajë dymbëdhjetë mbledhje. Gjatë vitit 2017 ka mbajtur gjithsej nëntë mbledhje të rregullta. Kuvendi i komunës gjatë vitit 2017 ka miratuar 2 rregullore dhe 28 vendime, që në krahasim me vitin e kaluar ku kuvendi i komunës ka miratuar 34 vendime dhe 6 rregullore. Lidhur me rendin e punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati ishte njëzëri për (prezent ishin 15 këshillat të komunës).

### **U MIRATUA RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2017.**

## **3. Shqyrtimi i raportit të punës së kryetarit të komunës për vitin 2017.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me rendin e punës hapi diskutimin

**Rufki Suma** thekson:- materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Nuriman Kuka** thekson:- përgëzoj punën e kryetarit të komunës por në raport vërejta disa ndihma qa janë dhënë për sportin por a janë në menaxhim të komunës. Fusha e futbollit ka filluar më herët me u ndërtuar dhe punët ende nuk janë përfunduar. Në të ardhmen a do ta kemi një fushë të futbollit ashtu siç duhet në Han të Elezit.

**Nora Xhoni** thekson:- rapporti i punës për vitin 2017 konsiderohet se ka të arritura dhe është bërë shumë duke ju referuar materialit të zyrës së prokurimit dhe materialit të drejtoreve. Për vitin 2018 a është planifikuar ndriçimi i rrugës së veteranëve të UÇK-së në lagje të re. A ka planifikuar drejtoria ndriçimin te shkolla fillore "Ilaz Thaçi". Aktivitetet dhe datat e rëndësishme të cilat janë me interes nacional mendoj që pak a shumë janë zbehur dhe kërkoj që në vitin 2018 të jetë si prioritet dhe një rëndësi e veçantë. Kyçja e autostradës a do të ketë joshje të investitorëve.

**Akif Shkreta** thekson:- për vitin 2018 të planifikohet nga drejtorit përgjegjëse që nëpër shkolla të ketë një kontroll të nxënësve të cilët kanë probleme me sy. Kjo është shumë e rëndësishme pasi jam pjesë e procesit arsimorë dhe e shohë që kemi një të metë të madhe të nxënësve të cilët kanë vështirësi në të pahurit.

**Teuta Shkreta** thekson:- duhet të bëhet ndriçimi i rrugës nga kufiri deri te hekurudha sepse ajo pjesë çdo herë është në lëvizje prej këmbësorëve dhe udhëtarëve të kufirit.

**Mefail Suma** thekson:- disa herë kam qenë asamblistë në asamblenë komunale dhe komunën e përcjellin disa dukuri negative prej që është formuar dhe ajo që më brengos është që zyrtarët komunal dhe ekzekutivi shumë pak e njojin drejtë shkrimin. Shënohen fjali pa asnjë presje dhe pikë që do të thotë nuk dinë që t'i përdorin shenjat e pikësimit. Është shënuar se Komuna e Hanit të Elezit me qëllim të realizimit të detyrave dhe obligimeve që dalin nga LVL dhe Statuti i Komunës ndër shumë aktivitete të cilat janë prezantuar në raportet e drejtorive dhe zyrave të ndryshme, ndër të cilat janë këto, çka kuptohet me këtë. E them këtë se zakonisht fjalitë kur shkruhen në fillim të fjalisë shënon kryefjala, pastaj më vonë shënohet kallëzuesori dhe këtu nuk gjemë kallëzuesorë se çka banë komuna e Hanit të Elezit. Mendoj që duhet të jetë komuna e Hanit të Elezit, me qëllim të realizimit të detyrave dhe obligimeve që dalin nga LVL dhe Statuti i Komunës, ndër shumë aktivitete të cilat janë prezantuar. Aktivitete gjatë vitit 2017 pika dy zhvillim profesional i punëtorëve në institucionet publike komunale. Deri më tanë asnjë herë nuk kam dëgjuar zhvillim profesional por kam dëgjuar zhvillim ekonomik, zhvillim i industrisë së rëndë zhvillim i industrisë së lehtë, kurse zhvillim profesional të njeriut nuk kam dëgjuar. Mendoj që duhet të thuhet aftësimi profesional, ngritja profesionale apo aftësim edukim i vazhdueshëm permanent i punëtorëve të administratës.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- në dy vende në raport shënon rroga dhe paga dhe a mund të ma shpjegon dikush se çka nënkuptohet. Në raport ka dilema , mospajtime, dyshime dhe të tjera të cilat janë çështje e procesit. Shpenzimet janë marramendëse duke filluar prej drekave zyrtare dhe jo zyrtare që është mirë të na i sqaroni se cilat janë zyrtare dhe cilat nuk janë zyrtare. Shuma në vlerë prej 17 253.66 € te drekat jo zyrtare nëse e shihni të arsyeshme një shifër kaq e madhe më doket jo interesant kjo. Dreka zyrtare 5600 € shpenzime telefonike diku 11 000 €, rregullim i lumenjve që me sa e di unë vetëm një lum e kemi dhe bien në dilemë se cilët lumeje janë . Kërkoj sqarim për shpenzimet për furnizimi me rrymë dhe transmisioni. Te investimet kapitale janë shpenzimet për garazhat dhe nuk është potencuar se për cilat garazha bëhet fjalë. Objektet memoriale, unë mendoj që është kompleksi i varrezave të Dëshmorëve në Puset e Nikës. Shuma e mjeteve financiare për mirëmbajtjen e automjeteve mu duket që është shumë marramendëse dhe ndër kohë ka edhe shpenzime për furnizim me vaj, antifirz , ujë për dritare por a nuk hynë në kuadër të shpenzimeve për mirëmbajtje të automjeteve. Për projektin furnizimi me dritare për shkollën e mesme "Dardania" a është kryer faza e inspektimit të këtij projekti dhe nëse është kryer a ka ndonjë devijim nga punë kryesi nga kriteret e tenderit të cilat i keni shpallur.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- është një shqetësim seriozë për peshat e rënda të fëmijëve filloristë të shkollës, jo vetëm për nxënësit por edhe për prindërit e nxënësve. Ky preokupim na përcjellë çdo ditë e më shumë. Ministria e Arsimit në bashkëpunim me drejtorinë komunale duhet të ndërmarr diçka në lidhje me këtë problem , në mënyrë që drejtoria komunale e arsimit të vendosë dollap nëpër shkolla që nxënësit të kenë ku me i lënë librat e tyre. Shfrytëzimi i këtyre dollapëve të jetë në menaxhimin e drejtorëve të shkollave sepse pasojat e fëmijëve tanë janë shumë të rënda nga kjo dukuri.

**Akif Shkreta** thekson:- është shqetësuese kjo dukuri edhe nëpër institucione qeveritare dhe nëpër tekste shkollore sepse i kam afër katër punime që kanë të bëjnë drejtë për drejtë me mbi ngarkesë gjuhësore të klasës së gjashtë të librave të biologjisë, gjeografisë, historisë dhe fizikës. Nuk pajtona me parafolësin për anën sintaksore që e potencon renditjen e fjalëve në fjali është shpërputhje që është nivel i lartë i aspektit gjuhësorë dhe nuk e zë shumë problem këtë. Problem e zë më shumë për shkak se në hyrje është shënuar zyra e personeli ose e ka shënuar kulturë pa shkronjë ë. Propozoj që ta instaloni programin e gramarit sepse do të ju ndihmon shumë në hartimin e dokumenteve.

**Mefail Suma** thekson:- unë nuk përmenda radhitje të fjalëve në fjali apo renditje të fjalëve në fjali. As nuk përmenda morfologi as sintaksë dhe nuk bëra analizë të emrit, unë potencova se dua ta dijë që komuna e Hanit të Elezit çfarë roli, çfarë funksioni luan momentalisht në këtë fjali dhe askush nuk mu përgjigj sepse nuk i kanë dhënë kur far përgjegjësi dhe kur far pune komunës së Hanit të Elezit por vetëm e kanë përmendur dhe kanë vazhduar. Është e vërtetë që janë radhitur fjalët e tjera por nuk kuptohen as ato dhe në shkrim mungojnë dy presje. Me bërë radhitjen e fjalëve në fjali pa presje dhe pa i përdorur shenjat e pikësimit e humbin efektin.

**Florim Shkreta** thekson:- a është e pajisur zona urbane e Hanit të Elezit me kanalizim atmosferik dhe fekal. A ka pas ndonjë ankesë nga qytetarët e komunës së Hanit të Elezit për këtë çështje. Kërkoj informacion me shkrim nga zyra e informimit dhe transparencës për çfarë arsyë më fshihen komentet në adresë të komunës së Hanit të Elezit.

**Rufki Suma** thekson:- sa i përket vërejtjeve të drejtshkrimit ka gabime por ka edhe gabime teknike. Ka edhe raste të cilat i marrim prej nivelit qendororë të cilat janë me gabime shumë. U përmenden disa çështje të cilat kanë të bëjnë me planifikimet dhe ne sot po e shqyrtojmë raportin e punës dhe kemi të bëjmë me atë që ka kaluar. Plani për vitin 2018 është miratuar dhe në ato planifikime hynë disa çështje të cilat u përmendën si kontrolli sistematik nëpër shkolla, ndriçimi i rrugëve. Në takim që kemi pas me drejtorin e "Bektelen-ës" kam kërkuar që me trajtuar rruga nga kufiri deri te hekurudha, me u zgjeruar dhe me u bërë ndriçimi. Autostrada është interes ma shumë kombëtarë se sa është lokal. Data e rëndësishme janë të planifikuara dhe mundemi me shtuar ndonjë datë nëse eventualisht nuk e kemi të planifikuar dhe që është e domosdoshme. Drekat zyrtare ka të bëjë me pijet e bifës dhe koktellet që brenda muajit bëhet 1000 € kurse për një vit kalon mbi 10 000 € dhe ka të bëjë me pijë por sistemi e kategorizon në atë mënyrë. Po ashtu paga dhe rruga janë njëjtë por në sistem disa vende shënon pagë dhe në disa rrrogë. Te rregullimi i lumenjve bëhet fjalë për prrockat

dhe lumin. Projekti i garazhës nënkuptohet në podrum që është regulluar për veturat për automjetet zyrtare. Është bërë mbulimi i parkingut të veturave zyrtare i cili quhet garazh. Për objektet memoriale bëhet fjale kryesisht për te varrezat e Dëshmorëve. Të çështja e furnizimit me vajra për automjetet është se antifrizi dhe vajrat janë shërbim dhe nuk hynë në kontratë te mirëmbajtja e veturave. Çdo projekt i cili del në tender nuk mund t'i bëhet pagesa pa e bërë nënshkrimin një komision për me bërë pranimin teknik , por te shkolla e mesme "Dardania" nuk ka përfunduar për shkak se ka ende dritare të cilat kanë nevojë me u rregulluar por nëse tenderi ka qenë vetëm për dhjetë dritare me i vendosë, janë vendosë , janë kontrolluar dhe është bërë pranimi teknik. U përmend fjala zhvillim te personeli por unë mendoj që mendimi ka qenë për aftësim profesional për zyrtarët të cilët do të trajnohen në lëmi të ndryshme. Çështja e peshës së rëndë të nxënësve e kemi përmendur disa herë por është përmendur edhe në nivel të Ministrisë. Çështjen e dollapëve e kemi menduar por mësimi zhvillohet në dy ndërrime edhe me dashtë me bërë është projekt i rëndë për me bërë dollp për çdo nxënës edhe për ndërrimin e paradites edhe për ndërrimin e pasdites. Për çështje të kanalizimit ka edhe në zonë urbane çështje të pakryer por mund të jetë rrugicë e vogël e cila ka defekte por ne planifikojmë me i bërë kanalizim të ri. Ankesa prej banorëve ka pas në rastet kur është zënë kanalizimi dhe kanë kërkuar ndihmë prej komunës. Sportit i kemi ndihmuar por në raporte del se sikur mos me pas ndihmuar për shkak se e kemi bordin për komunitet të kompanisë "Sharrcem" dhe ato ndihma nuk i përfshijmë në raportet tona sepse nuk janë mjete financiare të komunës.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- te çështja e projektit të dritareve më interesoj se a është kryer inspektimi i atij projekti dhe a përputhet me kriteret e tenderit.

**Rufki Suma** thekson:- nuk bëhet pagesë nëse nuk është në përputhje me kriteret e tenderit. Po ka raste që kur shpalen tenderët ka të meta dhe kompani shkon në bazë të asaj që është përcaktuar në tender.

**Nuriman Kuka** thekson:- fusha e sportit a e ka aftin se kur do të rregullohet. Kam informacione se kompania "Sharrcem" nuk është tu ndarë mjete financiare sikur se ka ndarë më parë.

**Rufki Suma** thekson:- fusha e sportit është projekt i Ministrisë së Mjedisit sepse në fillim kur është dëmtuar fusha është bërë me arsyetim se do ta pastron asbestin dhe me rikthyer në gjendje të më parshme, mirëpo vetëm e kanë dëmtuar fushën e futbollit dhe nuk kanë ndërmarr asgjë. Komuna është ankuar për çështjen e fushë dhe rastin e ka marr edhe policia e krimeve ekonomike sepse vetëm kanë dëmtuar dhe nuk e kanë rregulluar. Në momentin që kanë filluar ankesat Ministria e ka bërë një projekt për fushën e futbollit dhe najë ka dërguar dhe të njëjtës kompani ja kanë dhënë tenderi. Vitin e kaluar vetëm kanë filluar dhe e kanë shtruar me tamponë dhe kanë potencuar se këtë e kemi pas në projekt. Kemi bërë ankesë në Ministri dhe na është potencuar se projekti vazhdon për vitin 2018.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati ishte njëzëri.

#### **4. Miratimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2017.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi rexhallari** thekson:- komuna e Hanit të Elzit ka planifikuar të hyra vetanake për vitin 2017 në lartësi prej 239,854.00 €, kurse arkëtimi është në shumë prej 240,617.74 € apo 100.32 % e planit, që do të thotë se kemi tejkaluar planin e të hyrave vetanake për 763.74 €. Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2017 me Nr. 05/L-125 është 2,406,534.01 Euro, ndërsa ai përfundimtar është 2,694,975.90 Euro (duke përfshirë bartjen e të hyrave vetanake në shumë prej 86,192.14 €, bartjen e donacioneve të mbeturë në shumë prej 86.38 €, pastaj donacionet që kanë hyrë përmes llogarisë bankare nga Organizata Zvicerane Demos në shumë prej 36,841.07 € dhe në fund nga Qeveria e Republikës së Kosovës janë lëshuar mjete shtesë me datë 21.12.2017 në shumë prej 165,325.00 €). Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i realizimit të përgjithshëm për këtë periudhë janar-dhjetor 2017 është në shumë prej 2,422,548.10 € apo 89.89 %. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim pér këtë pikë tē rendit tē punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati ishte 12 pér, 3 abstenim.

## U MIRATUA RAPORTI I SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR VITIN 2017

### 5. Miratimi i planit tē punës së këshillit komunal pér siguri në bashkësi pér vitin 2018.

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë tē rendit tē punës hapi diskutimin.

**Rufki Suma** thekson:- plani është gati se i njëjtë pér çdo vit dhe janë tē njëjtat planifikime. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund tē parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- janë disa pika tē cilat duken se janë mirë tē planifikuara por puna e realizimit nuk e di a do tē bëhet. Është planifikuar trajtimi i qenve endacak dhe si do tē trajtohen këto pér shkak se keni potencuar se është e ndaluar me ligj. Cilat janë tē gjeturat e dukurive negative nga kontrollat tē cilat janë bërë nëpër shkolla. A janë mbajtur ligjërata pér çështje tē dukurive negative. Keni planifikuar aktivitet me KEDS-i por kush e merr përgjegjësinë sepse nuk e keni potencuar në plan. Pér organizimin e transportit tē nxënësve përgjegjësinë nuk e keni tē përcaktuar. A janë identifikuar deponit ilegale apo vetëm e keni paragjykuar që mund tē ketë.

**Florim Shkreta** thekson:- a ka pas ndonjë herë ndarje tē mjeteve financiare pér trajtimin e qenve endacak sepse çështja është e ndjeshme dhe është edhe kërcënëm pér fëmijët. Nëse ka pas mjete financiare sa ka qenë shuma e atyre mjeteve apo ndoshta janë keqpërdor mjetet financiare tē cilat kanë qenë tē ndara pér trajtimin e qenve endacak.

**Mefail Suma** thekson:- është planifikuar organizimi i transportit tē nxënësve tē cilët udhëtojnë në largësi, kërkoj informacion se sa konsiderohet largësia. Pér nxënësit e fshatit Dimcë është bërë rrezik edhe prej qenve endacak por edhe prej punimeve që po zhvillohen nga kompania "Bektelenka". A ekziston mundësia që së paku deri sa tē kryhen punimet e autostradës në atë pjesë që tē bëhet transporti i nxënësve tē ciklit tē ulët.

**Rufki Suma** thekson:- çështja e transportit është problem tē bëhet sepse ligji na obligon pér mi bartur nxënësit e ciklit tē ulët tē cilët udhëtojnë më shumë se pesë kilometra. Është mirë që përmes përfaqësuesit tē fshatit me biseduar me përfaqësuesit e kompanisë "Bektelenka" pér çështjen e transportit tē nxënësve deri sa tē kryhen punimet në atë pjesë. Para pesë viteve ka pas aksion pér eliminimin e qenve endacak sepse komuna ka marr vendim dhe i ka kryer shpenzimet. Eliminimi i qenve përmes vrasjes është ndaluar dhe titullojnë si trajtimi i qenve endacak. Janë krijuar disa kompani pér trajtimin e qenve endacak. Komuna nuk ka ndarë mjetë financiare pér shkak se nuk kemi tē drejtë pér është kompani profesionale e cila merret me këtë çështje. Nga niveli qendrorë na është thënë se në këtë vit do tē ndërmerret diçka pér këtë çështje sepse niveli qendrorë ka ndarë mjetë financiare pér çështjen në fjalë. Nëpër shkolla ka pas ligjërata kundër mjetet shpërthyese dhe kundër drogës. Është biseduar në takimet e KKSB-së se bisedohet që ka nxënës tē cilët merren me substanca narkotike dhe ka pas kontroll tē befasishme nëpër shkolla dhe asnjë element i dyshimtë nuk është gjetur përvëç dy apo tri pako tē cigareve. Arsyja që i kemi planifikuar çështjet me KEDS-in është se në KKSB është biseduar edhe pér shtyllat elektrike pér tē cilat banorët paraqesin ankesa me shkrim në mënyrë që komuna me biseduar me nivelin më tē lartë pér me u realizuar problemet që kanë tē bëjnë me rrymë. Drejtoria e shërbimeve publike i ka identifikuar vende që kanë deponi ilegale dhe planifikohet eliminimi i tyre përmes aksioneve që do tē ndërmerren me kompanitë , dhe me OJQ-të.

**Florim Shkreta** thekson:- vërehet se kryetari po i bjen punët shumë rrumbullak, mirëpo te prerja e drunjve në mënyrë ilegale nuk besojë që mund tē parandalohet kjo dukuri përmes drejtorisë pér bujqësi. Eliminimi i deponive ilegale është vështirë tē eliminohet sepse tē njëjtë persona i bëjnë këto deponi ilegale dhe nuk besojë që e zgjidhin këtë problem. U potencua më herët se dihen deponitë ilegal po disa dihen e disa nuk dihen pér shkak se i keni varros në fshatin Seçishtë. Këto foto ja kam prezantuar edhe gazetares Jeta Gjarra por nuk i ka prezantuar në emision.

**Besarta Suma** thekson:- në fshatin Dimcë janë disa objekte të cilat janë të vjetra dhe janë gati duke u rrënuar të cilat paraqesin rrezik për qytetarët të cilët kalojnë në atë pjesë. Është mirë që komuna të ndërmerr mas për këtë çështje sepse është rrezik për qytetarët të cilët kalojnë në atë pjesë.

**Rufki Suma** thekson:- te objektet është pak problem për shkak se janë objekte private, por drejtoria për shërbime publike del në vend të ngjarjes dhe bënë vlerësimin e çështjes në fjalë.

**Mefail Suma** thekson:- e përkrahi parafolësen sepse është mirë të ndërmerret diçka për këtë çështje për shkak se edhe fëmijët hyjnë brenda dhe luajnë me lojëra të ndryshme por nuk e mendojnë se çka mundet me ju ndodhë. Sa i përket deponisë ilegale e cila u përmendë në fshatin Dimcë unë mendojë që faji është i dy anshëm sepse me sa jam i informuar automjeti për bartjen e mbeturinave nuk ka pas forcë për me dal në fshatin Dimcë me bërë bartjen e mbeturinave. Tash është blerë një automjet i ri dhe bëhet bartja e mbeturinave në fshatin Dimcë por në bashkëpunim me komunën edhe fshatin do të bëhet pastrim dhe nuk do të ketë deponi ilegale në fshatin Dimcë.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati ishte njëzëri.

#### **U MIRATUAR PLANI I PUNËS SË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIHURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2018**

##### **6. Rishqyrtimi i vendimit të komitetit për politik dhe financa.**

**Kryesuesi** thekson:- kam mbajtur tri takime me shefat e grupeve parlamentare sepse Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që është në kundërshtim me ligjin dhe potencoitet që vendimi me numër 393 për themelimin e komitetit për politik e financa është në kundërshtim me ligjin për barazi gjinorë për shaka të mos përfaqësimit të barabartë të femrave në këtë trup të kuvendit. Gjatë bisedave me shefat e grupeve parlamentare është bërë një marrëveshje ndërpartiake që tri partitë politike të bëjnë plotësimin e gjinisë femërore në proporcion me kohën për mandatin katër vjeçar. Sipas llogaritjes së kohës të tri partive ju bien që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) muajve të bëjnë plotësim të gjinisë femërore në komitet për politik dhe financa. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- kemi pas takim në nivel të shefave të grupeve parlamentare, jemi dakorduar dhe e kemi lënë në kohë se si do të zhvillohet nëpër komunat e tjera të cilat janë më të mëdha dhe të shohim përvojat e tyre. Nëse keni informacion që në komunat e tjera ka filluar me u zbatuar ligji ashtu siç ka kërkuar MAPL-ja atëherë ne veç e kemi të gatshëm marrëveshjen.

**Kryesuesi** thekson:- mbledhja është thirr në fund të muajit me qëllim që me i pa edhe komunat e tjera, mirëpo vendimi duhet me u zbatuar. Marrëveshja është bërë dhe të parin mandat do ta ketë LDK-ja me plotësuar kuotën gjinore, pastaj VV dhe të fundit PDK-ja. Pra do të jetë me rrotacion. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati ishte 14 për , 1 kundër.

#### **U MIRATUA RISHQURTAMI I VENDIMIT TË KOMITETEIT PËR POLITIK DHE FINANCA**

##### **7. Miratimi i propozimit për dhënien e pëlgimit për kompaninë “ACHRO” SH.P.K.**

**Kryesuesi** thekson:- fillimisht fjalën ia jap përfaqësuesit të kompanisë.

**Mirieta Zatriqi** ( Koordinatore e Zyrës së kompanisë “ACHRO” SH.P.K) thekson:- kompania në Kosovë operon prej muajit shtatorë të vitit të kaluar dhe aktiviteti jonë kryesorë është nxjerra e mineraleve me anë të teknologjisë më të avancuar e cila funksionon vetëm me rrym dhe ujë dhe nuk ka asnjë ndikim në ndotjen e ambientit. Në këtë fazë që jemi përveç stafit në Prishtinë, kemi paraparë që t'i punësojmë edhe 55 punëtorë të tjere të cilët do të janë nga komuna e juaj , gjegjësisht nga ajo zonë atje ku do të ndërtohet fabrika. Në të ardhmen do ta mbështesim edhe komunitetin në fusha të ndryshme por kjo varet sipas kërkesave dhe nevojave të komunitetit.

**Teuta Shkreta** thekson:- kërkoj të dijë saktësish pikat se ku do të bëhet objekti dhe çfarë të mira do të përfiton fshati Gorancë pasi që ky fshat është ndër fshatrat më të mirë me ajër dhe natyrë të pastër.

**Nexhmedin Daci** thekson:- vend ndodhja do të jetë në parcelën me numër 1373-0 pronë e ekonomisë pyjore.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- keni potencuar se numri i punëtorëve do të jetë 55 dhe a keni ndonjë numër të saktë për në të ardhme se sa do të jetë numri i punëtorëve. Keni potencuar si kompani që do ta mbështetni komunitetin në fusha të ndryshme, mirëpo çka konkretisht parashihni.

**Florim Shkreta** thekson:- në çfarë mënyre jepini llogari ju nëse na ju mbështesim juve dhe ju nuk vazhdoni me punë.

**Sabedin Hasallari** thekson:- është një e mirë e madhe për ekonomin e komunës sonë dhe banorëve të kësaj ane. Në bazë të dokumenteve të ofruara shihet se është një kompani shumë serioze sepse ka potencuar se që në fillim do t'i punësojë 55 punëtorë. Kërkoj nga komuna që të ketë një kujdes të veçantë dhe një bashkëpunim seriozë me këtë kompani. Kërkoj nga asamblistët që unanimisht ta përkrahim këtë kompani sepse është serioze dhe do të jetë një e mirë për ekonominë e komunës sonë.

**Akif Shkreta** thekson:-nga materialet të cilat na janë prezantuar duket se është një kompani serioze sepse kemi pas përvoja jo të mira për shkak se kemi dhënë pëlqime të tillë dhe kanë mbetur në ajër që do të thotë kemi dhënë pëlqime të kota dhe kemi pas pretime të tillë si në punësim dhe nuk janë bërë. Mendoj që është një investim i mirë në bazë të dokumenteve që posedoni duke pas parasysh që edhe Hani i Elezit problem e ka punësimin dhe zhvillimin ekonomikë. A ka pas ndonjë shqetësim të banorëve në atë pjesë. Në rastet e tillë duhet të jemi unikë dhe të ju ndihmojmë kompanive.

**Nuriman Kuka** thekson:- në bazë të dokumentacionit që ka prezantuar kompania shihet që është në rregull por vetëm ju uroj suksese në këtë drejtim.

**Mefail Suma** thekson:- potencoher se me anë të teknologjisë më të avancuar e cila funksionon me ujë dhe rrymë , mirëpo atje ujë nuk ka, ku do ta merrni ujin. Kompania në dokumentacion ka prezantuar një licencë hulumtimi dhe për çfarë arsyet nuk është sjellë licenca e punë por është sjellë vetëm e hulumtimit.

**Mirieta Zatriqi** ( Koordinatore e zyrës së kompanisë “ACHRO” SH.P.K) thekson:- nxjerra e mineralit do të bëhet me anë të teknologjisë shumë të avancuar dhe është e garantuar se nuk e ndotë ambientin. Fshati do të përfiton punësim dhe në të ardhmen do të rritet numri i punëtorëve. Numri i punëtorëve prej 55 do të janë vetëm për këtë vit dhe shpresojmë që në të ardhmen do ta kalojnë numrin 100 mirëpo një herë të fillojmë punën dhe ky numër i punëtorëve duhet në këtë vit gjithsesi. Mbështetja e komunitetit do të bëhet në bazë të kërkësave që do të parashtohen. Mbështetja e komunitetit do të jetë edhe në pasurimin e hapësirave të gjelbërtë. Do të shikojmë mundësi që sektorin e shëndetësisë me mbështetur. Ne i raportojmë investitorit i cili ka investuar dhe do të investon me mjete financiare, mirëpo do të kërkon llogari nga ne se çka kemi bërë. Investitori e ka studiuar vendin dhe tregun por këto dilema i kemi hequr dhe do të jemi shembull për kompanitë e tjera të këtij lloji. Sa i përket çështjes së ujit i kemi pas ekspertët tanë në vend dhe i kanë bërë matjet të cilët kanë konstatuar se ujë ka mjaftueshëm, mirëpo pa pëlqimin komunal nuk mund t'i fillojmë punimet. Licencën për hulumtim e kemi për shkak se për momentin jemi në fazën e hulumtimit dhe këto shkojnë hap pas hapi në mënyrë që pasi të kryhen hulumtimet aplikojmë në KPMM për licencat e tjera.

**Rufki Suma** thekson:- u paraqitë shqetësim prej këshilltarëve për shkak se kemi një përvojë të hidhur jo vetëm në mandatin tim por edhe në mandatet e përparshme që kompanitë e ndryshme për përfitime marrin leje dhe licenca vetëm sa për të përfituar dhe për t'i shituar dhe asnjë herë deri më sot nuk ka vepruar askush pozitivisht. Çdo kompani e cila ka ardhur në kuvend i kemi potencuar se po dyshojmë se nuk do të vepron në aspekt pozitiv por me gjithë atë asnjë herë nuk i kemi bllokuar dhe 99 % të rasteve gjithmonë ju kemi dhënë pëlqim. Para dy apo tri viteve kemi dhënë pëlqim për kompaninë që i ka kryer hulumtimet por me rezervat tonë që do të mbetet vetëm në letër. Ne kemi potencuar që me qëllim të nxitjes së investitorëve dhe me qëllim të

punësimit kuvendi i komunës ka miratuar rregullore më të cilën i liron nga taksa për dy vite biznese të cilat janë të reja. Kemi dhënë pëlqime të ndryshme deri më sot por fatkeqësisht kemi pas ndonjë ndërtim pozitiv. Në momentin e ardhjes së kësaj kompanie e cila selinë e ka në Zvicër na ka bindur se tani kemi rënë në dorën e vërtetë të kompanisë për shkak se deri tash lirishtë mund të them se kanë qenë matrapazë. Vijnë dhe kërkojnë pëlqimi të ndryshme dhe vetëm i uzurpojnë pronat, po i uzurpojnë licencat dhe mandej po bëjnë pazare për fitime të ndryshme me kompanitë serioze dhe kompania serioze po detyrohet që me i paguar kompanitë e më parshme me mjete financiare vetëm e vetëm për me marr licencën. Si komunë e kemi biseduar këtë çështje dhe jemi dakorduar që kjo kompani të punon në territorin tonë. Kemi edhe një reagim të fshatit që kërkojnë që bashkarishtë t'i ndihmohet edhe fshatit.

**Teuta Shkreta** thekson:- shpresoj që të ketë pëlqimin nga të gjithë banorët e fshatit Gorancë pasi që keni pasur bisedime. Unë mendojë që nëse ne do ta votojmë, në të ardhmen të bëhet një pjesë turistike që do të ishte i mirë për komunën tonë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- deri më tani dimë që ka pas kompani të ndryshme të cilat kanë marrë pëlqim nga komuna por deri më tani nuk jemi për me penguar asnjë kompani, mirëpo jemi për me i stimuluar dhe si parti demokratike do ta votojmë por duhet të jetë e kujdesshme edhe kompania që mos të shkon sikur kompanitë e tjera vetëm me marr licenza dhe mi usurpuar pronat, por duhet tëjenë shumë seriozë për këto të cilat po i potencojnë që ne të bindemi për me i votuar. Grupi parlamentarë i PDK-së do ta voton për kërkesën e kompanisë.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati ishte njëzëri.

#### U MIRATUA PRPOZIMI PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR KOMPANINË “ACHRO” SH.P.K.

#### 8. Shqyrtimi i informatës mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2017-2018

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Menduh Vlashi** thekson:- është bërë një gabim në tri faqet e fundit është shënuar 2016-2017 por e kam rregulluar dhe e kamë shënuar 2017-2018. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- është potencuar që suksesi është rrit por nuk u bazove në notën mesatare sepse në bazë të notës mesatarë vlerësohet suksesi. Informatën mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2017-2018 të cilën na i keni dërguar vërehet se ka një rënie në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2017-2018 duke e krahasuar me vitin shkollorë paraprakë që do të thotë se në të gjitha shkollat ka rënie të suksesit, ndoshta është i vogël por me gjithë atë ka rënie. Më intereson ta dijë se cilët janë faktorët të cilët kanë ndikuar në rënien e këtij suksesi. A keni njohuri rrëth përdorim të lëndëve narkotike nëpër shkolla për shkak se qarkullojnë biseda se ka përdorim të lëndëve narkotike, ndoshta në mas të madh jo dhe ndoshta të llojeve të ndryshme. Mungesa e nxënësve në gjysmëvjetorin e para 23 065 mungesa, a mendoni që është numër tepër i madh i mungesave, cilët janë shkaktarët. Orë të pa mbajtura të arsimtarëve janë 787 orë dhe mendoj që është shqetësues ky numër i orëve.

**Samire Curi** thekson:- në shkollën e mesme “Dardania” ka rënie të mungesave të mësimdhënësve, kurse në të gjitha shkollat e tjera ka ngrit që konsiderojë që është rezultat i drejtorit. Kërkoj nga drejtoria për arsim që të ndërmerret edhe nëpër shkollat tjera.

**Mefail Suma** thekson:- kur është zhvilluar mësimi para lufte nëpër shkolla ka qenë më i fortë sepse notë mesatare nuk ka pas që sikur sot që po i fryjnë, nuk ka qenë i gjithë personeli i diplomuar por është punuar. Po të shikohet sot nuk është krejt zi por mu më doket se diçka qalonë arsimi e nuk shkon në atë kuptimin sikur kemi dëshirë ne të bëjmë. E potencoje këtë për arsyen se shpesh takohem me lloj lloj cikli të nxënësve të cilët i pyes dhe i shikoj se sa kanë arritur mësim nxënësie, mirëpo përgjigjja prej tyre është se nuk e kemi mësuar. Mendoj se arsimi me një far mënyre është pak i kapt. Në shkollën fillore "Veli Ballazhi" në fshatin Gorancë gati 12 (dymbëdhjetë) vite është një drejtor athu a nuk ka më të mirë po vetëm ai është. Është mirë me ju lënë rend edhe vend personave të ri që ne ta ndryshojnë mendimin në mënyrë që ta din se edhe ato munden me ardhur drejtor dhe me u punësuar. Në tabelarin numër 1 (një) shohë se janë dy punëtorë të pakualifikuar njëri në shkollën fillore "Ilaz Thaçi" dhe njëri në shkollën fillore "Veli Ballazhi". Çfarë kualifikimi kanë tash dhe a banë të dihen emrat e personave. A është shpallur vendi i lirë ndonjë herë i këtij arsimtarë? Nëse është shpallur, pse nuk është plotësuar? Nëse nuk është shpallur për çfarë arsyen nuk është shpallur vendi i lirë i punës. Nëse jeni fanatik për ruajtjen e vendeve të punës shumë punëtorë keni prej komunës së Kaçanikut që ka pas raste që ka pas studentë gati në diplomim, kurse janë pranuar persona nga Kaçaniku. Në paralelen "Ilaz Thaçi" në fshatin Krivenik ka qenë një punëtorë i pa kualifikuar dhe ju ka shpallur vendi i lirë i punës dhe është larguar nga puna.

**Besarta Suma** thekson:- a janë të përgatitur stafi për zbatimin e kurikulës së re në shkollën fillore "Kështjella e Diturisë" dhe në shkollën fillore "Veli Ballazhi" dhe pse është lejuar pa u bërë trajnimi i stafin për këto shkolla. Programi edukativo arsimorë Skullmi sa praktikohet te ne në shkolla për deri sa rrjeti i internetit është i dobët. Pse disa arsimtarë në shkollën fillore "Ilaz Thaçi" nuk kanë lloaptop.

**Akif Shkreta** thekson:- për periudhën më të hershme të arsimit nuk po flas por po flas për periudhën që jam vetë akterë i arsimit nuk mendojë ashtu që do të thotë që është me një farë mënyre më shumë zi se sa bardh sepse Hani i Elezit ka filluar së zbatuari kurikulen e re dhe është viti i katërt që po e implementonë shkolla fillore "Ilaz Thaçi", ndërsa në shkollën fillore në Paldenicë dhe Gorancë ka filluar me vonesë. Drejtoria e arsimit a ka bërë ndonjë program që mësimdhënësit e këtyre dy shkollave të janë pjesë e trajnimit për kurikulen e re dhe ju rekomandojë të gjithë atyre që janë pjesë e udhëheqjes dhe menaxhimit në arsim së pakut a lexojnë kornizën e kurikulës së arsimit për shkak se ka dallime shumë të mëdha në mësimdhënien e dikurshme dhe në mësimdhënien e tanishme. Kërkoj nga drejtoria për arsim që ta riaktivizon ujin e pjesë në shkollën fillore "Ilaç Thaçi".

**Menduh Vlashi** thekson:- po që se nisemi në bazë të notës mesatare kemi rënie por vazhdimisht kur kam qenë drejtorë e kam parë veten më mirë kur kemi pas notë mesatare më të ulët se sa më të lartë. Kanë filluar arsimtarët me kuptuar se kot është të jepet nota pesë kur nuk dinë dhe nëse vlerësohet mirë përmua është një bindje që është duke u punuar dhe po i kushtohet rëndësi cilësisë në mësim. Sa i përket përdorimit të substancave narkotike është diskutuar edhe në KKSB dhe u kam sugjeruar që të flasin me emra nëse dihet se kush dhe ta gjejmë. Në saje të asaj që po flitet këshilli i prindërve ka marr një aksion në bashkëpunim me këshillin e drejtorisë së shkollës së mese dhe kanë kontrolluar dhe substanca nuk kanë gjet përvicë se një apo dy pako të cigareve. Është e vërtetë që mungesat e nxënësve janë të mëdha por më shumë brengosëse janë mungesat e arsimtarëve dhe vazhdimisht në takim ju ka thënë drejtorëve të shkollave se deri sa të ketë mungesa të mëdha të arsimtarëve nuk mund të jetë nota mesatare 3.59. Pra deri sa të ketë mungesa edhe të nxënësve edhe të mësimdhënësve përmua është e pa pranueshme kjo notë mesatare.

**Mehmet Ballazhi** thekson:-nuk kontestova notën mesatare por qëllimi ke i rënies së notës mesatare sepse po e dimë që edhe notat të cilat janë të nxënësve nuk janë krejt reale. Më intereson se si mi gjet faktorët e rënies së notës mesatare kur dihet se numri i punëtorëve është shumë më i mirë dhe më i kualifikuar se sa ka qenë para pesë viteve apo dhjetë viteve kurse suksesi është më i dobët.

**Menduh Vlashi** thekson:- u potencua që në shkollën mesme ka rënien të mungesave që është e vërtetë sepse drejtori ka pak më shumë kriterium për nxënës edhe për profesorë se sa në disa shkolla fillore. U përmendë se më shumë është mësuar nëpër shtëpi-shkolla që unë mendoj se vullneti ka qenë më i madh, mirëpo me përfundimin e luftës për çdo vit ka rënë vullneti i mësimdhënësve. Unë mendoj se kjo rënien është më shumë për shkak të kurikulës sepse një pjesë e punëtorëve hezitojnë me punuar me plan program të riqjë. Arsimtarë i pakualifikuar dihet se kush është në shkollën fillore "Veli Ballazhi" dhe nuk do ta shpallim konkurs sepse i ka mbetur edhe një vit për me u pensionuar. U potencua që arsimi është i kapt dhe unë nuk besoj që është ashtu.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës së rendit të punës.

## **9 . Miratimi i kërkesës së z.Muhamed Suma për ndërrim destinim të pronës.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Zaim Bela** thekson:- materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati ishte njëzëri.

### **U MIRATUA KËRKESA E MUHAMED SUMA PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS**

#### **1. Pyetje dhe përgjigje.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sabrije Krasniçi** thekson:- me datë 25.02.2018 është mbajt mbledhje dhe për atë mbledhje ftesë ka pas edhe kryetari i komunës dhe në atë takim është vendosë me mbajt protestë. Protesta është mbajt dhe besoj që e keni pas se ka qenë edhe në media. A keni komunikuar me banorët se çka do të bëhet me këtë rrugë.

**Mefail Suma** thekson:- a ka mundësi komuna me i subvencionuar edhe individët të cilët i kanë një, dy apo tri gjedhe qumështore sepse Ministria përkatëse i subvencionon vetëm ata të cilët i kanë pesë gjedhe qumështore e më shumë.

**Sabedin Hasallari** thekson:- rruga e cila shkon në fshatin Gorancë nga shtëpia e z.Nexhmedin Fida e deri te shtëpia e z.Demir Bajramliu me vendosë rrjeta metalike sepse paraqet rrezik ajo rrugë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- pse janë ndërprerë vizitat shtëpiak të shëndetësia sepse pas dite ka raste që moshat e vjetra kanë probleme dhe askush nuk mund të shkon në vizitë shtëpiake. Pse është ndërprerë kjo për arsyen se deri tash ka funksionuar. Për çështjen e zhvillimit të punimeve nga kompania "Bektellenka" duhet me diskutuar ma konkretisht për shkak se po bëhet ndotje.

**Nuriman Kuka** thekson:- a ka komuna jonë ndonjë projekt të cilin e ka dërguar në Qeveri dhe sidomos a ka dorëzuar ndonjë projekt për çështjen e ujit të pijes.

**Akif Shkreta** thekson:- propozoj që çështjet që kanë të bëjnë me "Bektelenkën" të diskutohen për mbledhjen e ardhshme.

**Florim Shkreta** thekson:- kërkoj përgjigje me shkrim për pyetjet të cilat do ti parashtroj. Kërkoj informacion me shkrim nga kryetari i komunës për vizitën e 28 nëntorit në Shqipëri. A ka qenë zyrtarisht dhe me këndë jeni takuar në Shqipëri dhe kush ka marr pjesë. Kërkoj informacion me shkrim si kryesues i kuvendit sepse edhe ju ishit në Shqipëri për datën 28 nëntor i vetëm si kryesues sepse ka qenë e planifikuar që si kuvend të shkojmë bashkërisht. Kërkoj informacion me shkrim për pedagogun z.Irfan Qajani se sa muaj ka qëndruar drejtore pasi është zgjedhur pedagog. Kërkoj listën e personave të cilët janë të kontraktuara me kompaninë e pastrimit të mbeturinave. Kërkoj listën e personave të cilëve u është dërguar lënda në përmbarues privat. Kërkoj listën për të gjithë banorët e Hanit të Elezit të cilëve u barten mbeturinat dhe të cilët nuk kanë kontratë.

**Rufki Suma** thekson:- sa i përket projektit për ujë kemi diskutuar disa herë që është kompetencë e nivelit qendrorë dhe jemi në bisedime por secilën herë e më tepër shkojnë duke e neglizhuar punën. Në marrëveshjen që e kemi pas kanë potencuar që prej muajit Janar me filluar pagesa e ujit në lagje të re dhe me vazhduar rehabilitimi i ujit në pjesën tjetër. Jemi dakorduar me zyrën Zvicerane si financues të projektit që deri në muajin qershor me përfunduar mirëpo edhe atë herë kam dyshuar dhe prapë dyshojë. Si komunë nuk na lejojnë neve me u marr me çështje të ujit përveç që kemi ndarë mjetë për hulumtim mirëmbajtjen dhe menaxhimin e ujit nuk na lejojnë me bërë vetë. Vizitat shtëpiake nuk janë ndërprerë dhe nuk besoj që ka ndonjë vendim për ndërprerjen e vizitave shtëpiake, mirëpo mund të ndodhë pasdite me kërkuar mjekun por ai nuk ka të drejtë me lëshuar ambulanten, por kjo çështje ka shkuar me mirëkuptim dhe ka pas raste që mjeku ka shkuar në vizitë edhe pse e ka pas të ndaluar me lëshuar ambulanten. Unë nuk di që ka pas ndonjë rast emergjentë që nuk ka shkuar tekniku medicinal për ndonjë injekzion.

**Teuta Shkreta** thekson:- në popullatë kjo çështje është marr si obligative se për një injekzion me lajmëruar ambulantë se vjen dhe ambulanta ka shpenzuar më shumë derivate për këtë çështje. Rastet urgjente nuk ndërprehën asnjë herë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:-unë vetëm parashtrova pyetjen se a ka ndonjë vendim apo udhëzim administrativ që janë ndaluar vizitat shtëpiake për shkak se vizitat kanë qenë dhe tash kam informacione që janë ndërprerë .

**Rufki Suma** thekson:- komuna ka dhënë subvencione edhe për fermerët të cilët kanë pas më pakë se pesë gjedhe por kjo ka ndodhë kur komuna ka pas mjete financiare. Pavarësisht reduktimeve të mallrave dhe shërbimeve apo projekteve nuk na lejohet për shkak se është e caktuar shuma për subvencionet. Me "Bektelenken" nga fillimi i punimeve në komunë e Hanit të Elezit nuk e kemi lejuar me punuar pa pëlqim të komunës në pronësinë publike dhe u kemi potencuar çka do që dëmtohet duhet ta ktheni në gjendje të mëparshme, kurse në pronësi private pa pëlqimin e pronarit privat nuk keni të drejtë me hyjë. Që në atë kohë kur kanë filluar punimet kemi kërkuar që asnjë rrugë mos me u mbyllur, po ashtu kemi diskutuar edhe përrugën Dheu i Bardhë-Paldenicë. Kemi diskutuar edhe përrugën Uji i Thartë-Ramuk me mbetur rrugë e hapur mirëpo pronarët privat nuk e lejojnë. Përrugën Dheu i Brdhë-Paldenicë kemi biseduar disa herë dhe kanë kërkuar pëlqim për me i zhvilluar punimet por nuk i kemi dhënë për shkak se nuk kanë dhënë garancionë që rruga do të jetë e hapur. Kompania ka deklaruar që neve na vihet për me i zhvilluar punimet por a mbetet rruga a nuk mbetet vendosë Ministria dhe me rekomandimin e Ministrisë i kemi dhënë pëlqim për me i zhvilluar punimet. Nuk është definuar a me pas rrugë apo mos me pas dhe si komunë e kemi kërkuar që rruga mos me u mbyllur. Banorëve ju kam sugjeruar që komuna është në anën e juaj por edhe ju mos rrini në heshtje por kërkonin që rruga mos me u mbyllur. E kemi diskutuar çështjen e ndotjes dhe kanë filluar me përdor edhe ujin por është krijuar balt edhe më e madhe por janë munduar dhe nuk e kanë lanë për neglizhencë. Për çështjen e rrugës kam biseduar edhe me Ministrin përkatës dhe ka premtuar që do të del në teren por deri më tanë konkrete nuk ka diçka.

**Sabrije Krasniçi** thekson:- a keni biseduar për gypat të cilët po i vendosin nëpër prrocka dhe mbi te po e vendosin një sasi të madhe të dheut e cila mund të peshoj dhe t'i zënë gypat dhe do të jetë problem në të ardhmen për komunën.


• **Rufki Suma** thekson:- çka do që ka vërejtje duhet të prezantohen nga kryetari i këshillit të fshatit dhe komuna ja paraqet kompanisë “Bektelenka”.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë rendit të punës, nëse nuk ka ju faleminderit në pjesëmarrje

Mbledhja përfundoi në ora 13:30.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



**Kryesuesi i Kuvendit  
MSc. Qamush Brava**